



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:113683
Datë: 27.12.2024
Numri i dokumentit: 06663621

K.DH.SH.II.nr.461/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Gero” shpk, me NUI811255216, me seli ne Prishtinë Zona Industriale 1, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zijadin Spahiu avokat ne Prishtinë, ndaj debitorit “Q10 Construction” shpk, me NUI810751017, me seli ne Pejë rr. “UÇK” te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Lulzim Balaj avokat ne Pejë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.604/23 dt.14.08.2023, me datën 27.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e debitorit “Q10 Construction” shpk, me NUI 810751017, me seli ne Pejë rr. “UÇK”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 604/23 dt.14.08.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.604/23 dt.14.08.2023, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit “Q10 Construction” shpk, me NUI 810751017, me seli ne Pejë rr. “UÇK”, ndërsa urdhrin përmbarimor P.nr.59/23 dt.08.03.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj me seli ne Prishtinë e ka lënë ne fuqi dhe detyron debitorin qe ne emër te shpenzimeve për përpilim te përgjigjes ne prapësim ti paguaj kreditorit shumën prej 104 euro, ne afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te dispozitave te LPP, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, urdhrin përmbarimore ta shfuqizoj dhe ta obligoj kreditorin ti paguaj shpenzimet përmbarimore.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Gero” shpk, me NUI 811255216, me seli ne Prishtinë Zona Industriale 1, me datën 08.03.2023, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit “Q10 Construction” shpk, me NUI 810751017, me seli ne Pejë rr. “UÇK”, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës me nr.13/20 dt.13.03.2020. Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.59/23 dt.08.03.2023, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga fatura t’i paguaj shumën e mbetur të papaguar prej 4,943.17 euro, me kamatë prej 8% nga dita kur borxhi është bërë i arritshëm e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori, me datën 03.04.2023 ka paraqitur prapësim, me pretendimin se dokumenti i prezantuar nga kreditori nuk është dokument i besueshëm sepse i njëjti ka prezantuar faturën e përgjithshme ndërsa shuma është pjesërisht e kërkuar. Propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbarimor se bashku me veprimet ti anuloj dhe ta obligoj kreditorin ti paguaj shpenzimet procedurale

Përgjigje ne prapësimin e debitorit me datën 05.04.2023 ka ushtruar kreditori, me pretendimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori ne prapësim, se debitori një pjesë të detyrimit e ka paguar ndërsa i ka mbetur edhe shuma prej 4,943.17 euro pa e paguar dhe se me e arsyeshme ka qenë që debitori të kërkojë afat shtesë për pagesë se sa të paraqes prapësim. Propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit, urdhri përmbarimor të mbetet ne fuqi ndërsa të obligohet debitori ne pagesën e shpenzimeve përmbarimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës se Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.604/23 dt.14.08.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, po ashtu vlerëson se urdhri është lejuar nga përmbaruesit privat bazuar ne faturën nr.13/20 dt.13.03.2020 e cila i përmban tiparet e dokumentit të besueshëm, ne te janë përshkruar te dhëna te mjaftueshme për palët, përshkrimin e mallrave objekt i faturës, shumen e detyrimit për përmbushje nga ana e debitorit si dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit, e po ashtu i plotëson edhe kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, pasi është dorëzuar në origjinal. Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e debitorit por vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga kushtet e parapara për anulim të urdhrin përmbarimor nga neni 71 i LPP ndërsa ne kuptim te nenit 73 par.1 te LPP ka vendosur jashtë seancës gjyqësore si ne dispozitiv te aktvendimit te saj.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës se Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe 183 te LPK,

për të cilat shkelje Gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbartimor, e kjo bazuar në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ashtu që ka dhënë aktvendim të drejt dhe ligjor, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve edhe kësaj gjykate i rezultoi se fatura nr.13/20 dt.13.03.2020 mbi bazën e te cilës është lejuar përmbartimi plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm konform nenit 29 par.3 te LPP i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar“* dhe nenit 37 të LPP-së i cili thotë se *“kur propozimi për përmbartim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton që propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë ne origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, e që ne këtë rast rezulton se fatura si e tillë është e përshtatshme për ekzekutim, pasi është e nënshkruar nga debitori dhe ne këtë mënyrë konsiderohet se është pranuar ne mënyrë te rregullt nga i njëjti dhe se propozimit për përmbartim i është bashkangjitur ne origjinal.

Sa i përket pretendimeve te debitorit se kreditori nuk ka përmbyllur ne tërësi punimet dhe se për këtë arsye nuk është kryer pagesa përfundimtare kjo gjykatë gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit dhe përshtatshmërisë së këtij dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbartimi.

Kompetenca e Dhomës se Shkallës se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës se Dytë
K.DH.SH.II.nr.461/24, datë 27.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova